

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti për krime të rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Mejreme Memaj , kryetare, Dr.sc.Driton Muharremi e Afrim Shala, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Leonita Lajçi, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit Sh.K. nga Prishtina, për shkak të veprave penale shtytja për kryerjen e veprave terroriste nga neni 141 i KPRK-së, nxitja e urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit kombëtar, racor, fetar apo etnik nga neni 147 par.2 i KPRK-së dhe shmangia nga tatimi nga neni 313 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për krime të rënda, PKR.nr.65/17 datë 23.03.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me 20.09.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për krime të rënda, PKR.nr.65/17 datë 23.03.2018, **vërtetohet.**

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktgjykimin PKR.nr.65/17 datë 23.03.2018, të akuzuarin Sh.K. konform nenit 364 par.1 pika 1.3 të KPPRK-së e ka liruar nga akuza për shkak të veprave penale shtytja për kryerjen e veprave terroriste, nga neni 141 KPRK-së, nxitja e urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit kombëtar, racor fetar apo etnik nga neni 147 par.2 të KPRK-së dhe veprës penale shmangia nga tatimi sipas nenit 313 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së. Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur:

-Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën në mënyrë që aktgjykimin e ankimuar ta anulojë dhe lëndën ta kthejë në rigjykim.

-Përgjigje në ankesën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës ka paraqitur mbrojtësi i të akuzuarit Sh.K., av.S.Z. me propozim që Gjykata e Apelit ta refuzojë ankesën e PSRK-së kurse aktgjykimin e ankimuar ta vërtetojë.

Prokurori i Apelit me parashtresën me shkrim PPA/I.nr.242/18 të dt.01.06.2018, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, aktgjykimi të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje ndërsa të refuzohet përgjigjja në ankesën e PSKR-së e parashtruar nga mbrojtësi i të akuzuarit Sh.K., av.S.Z. si e pabazuar.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje juridiko-penale studio aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

-ankesa nuk është e bazuar

Aktgjykimi i shkallës së parë ankimohet nga ana e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat ndërlidhen me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, të paraparë me nenin 384 par.1, pika 1.12 sepse aktgjykimi i ankimuar nuk është përpiluar në pajtim me nenin 370 të KPP-së, saktësisht par.7 të këtij neni. Aktgjykimi ankimohet edhe për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike duke theksuar se gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë vlerësim të plotë të dëshmimeve të dëshmitarëve M.H. dhe N.A.. Gjykata në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar fare nuk i ka konsideruar relevante dhe të rëndësishme mendimet e Bashkësisë Islame të Kosovës, në vërtetimin e ndonjë rrethane konkrete sa i përket kësaj çështje penale të cilin vlerësim Prokuroria e konsideron si të gabuar. Sa i përket shkeljes së ligjit penal, prokuroria konsideron se vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike ka bërë që aktgjykimi i ankimuar të ketë edhe shkelej të ligjit penal në dobi të akuzuarit dhe në rastin konkret zbatim të ligjit i cili nuk do të duhej të zbatohet.

-Mbrojtësi i të akuzuarit Sh.K., av.S.Z. me përgjigjjen në ankesë të ushtruar ndaj ankesës së PSRK-së pretendon se Prokurori në aktgjykimin e kundërshtuar me ankesë nuk ka arritur të gjegjë asnjë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nuk ka mundur të identifikojë asnjë shkelje të ligjit penal dhe sipas mbrojtjes nuk ka qenë në gjendje të bëjë dallimin midis vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike. Aktgjykimi flet të kundërtën e asaj që ankesa përmban. Deklaratat e dëshmitarëve aktgjykimi i ka paraqitur në tërësi në mënyrë objektive, aktgjykim i cilli është i drejtë, i bazuar në prova shumë mirë të analizuara dhe të vlerësuara në përputhje me mënyrën e vlerësimit që ka paraparë ligjvënësi.

Gjykata e Apelit e Kosovës, vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të pretenduara në ankesë nga Prokuroria e as shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare. Dispozitivi i aktgjykimit është i qartë dhe i kuptueshëm, dhe se gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsyet e mjaftueshme lidhur me aktgjykimin lirues për të akuzuarin Sh.K. e të cilat si të tilla i pranon edhe kjo gjykatë. Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar secilën provë veç e veç, të njëjtat i ka ndërlidhur me njëra tjetrën, ka dhënë arsyet për faktet vendimtare si dhe arsyet e mosmiratimeve të propozimeve konkrete të palëve por edhe arsyet në të cilat është bazuar me rastin e zgjidhjes së kësaj çështjeje penalo-juridike. Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, gjykata e shkallës së parë drejt dhe në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike kur ka marrë aktgjykimin lirues. Në tërësi Gjykata e Apelit e Kosovës i mbështetë arsyetimet

dhe vlerësimet e provave të paraqitura në shqyrtimin gjyqësorë si dhe me vendosjen e kësaj çështjeje penalo-juridike. Gjykata e shkallës së parë ka administruar provat materiale dhe atë dëshminë e dëshmitarëve S.M., M.H. dhe N.A. si dhe provat materiale si: përgjigjja nga kryesia e BIK-ut, të datës 28.10.2016, 2 CD me përmbajtje të ligjëratave të publikuara të të akuzuarit Sh.K. “Ndhmone Sirinë” dhe “Revolucioni sirian” video në CD të marrura nga youtube, raporti i veçantë mbi të gjeturat e tërësishme kundër të akuzuarit Sh. të datës 24.11.2016 ku përfshihen: fotografi dhe dokumente të ndryshme të nxjerra nga ekzaminimi të paisjeve të sekuestrara në konviktet e femrave tek parku i qytetit, dokument me pjesë të shkëputura të intervistimit nga tna i akuzuari, të akuzuar dhe të dënuar për terrorizëm përfshirë edhe disa dëshmitarë, transkripti i audio-vidoincizimeve “Ndhmone Sirinë” dhe “Revolucioni sirian”, dhe “Sh.K. flet me adhurim për dënimin me prerje duarsh”, komunikimet e ndërsjella me SMS, raport informues lidhur me rastin PPS.nr.117/14 i datës 26.01.2017, raport kontrolli nga ATK me numër të dosjes 1096 i datës 28.12.2016, aneks raport kontrolli-rezultati financiar sipas periudhave tatimore datë 28.12.2016, raporti i ekspertit financiar i datës 03.02.2017, konfirmimi nga TEB banka i datës 14.02.2017 dhe autorizimi i datës 21.09.2011, katër libra të emërtuar “Qëndrimi në kohë” me autor të akuzuarin Sh.K. dhe një CD me materiale të ndryshme-video incizime të ligjëratave të të akuzuarit, prova këto të arsyetuara secila veç e veç nga ana e gjykatës së shkallës së parë e të ndërlidhura me njëra tjetrën duke ardhur te një gjendje faktike si në dispozitiv të aktgjykimit të shkallës së parë.

I akuzuari Sh.K. akuzohet për veprën penale të shtytjes për kryerjen e veprave terroriste nga neni 141 i KPRK-së e që si dispozitë përmban se kryesi i kësaj vepre shpërndan ose në ndonjë mënyrë tjetër mundëson mesazhin për publikun me qëllim që të shtytë kryerjen e aktit terrorist kur sjellja e tillë pavarësisht nëse avokon drejtpërdrejtë ose jo aktet terroriste shkakton rrezikun që një ose më shumë vepra të tilla të kryhen e që kërkohet që e njëjta të jetë në mënyrë publike duke shtytë personat që janë të papërcaktuar që të kryejnë vepra terroriste e që kërkon që kjo thirrje ose mesazh të përmbajë përmbajtje të asaj natyre, që shkaktojnë rrezik që ndaj personave të caktuar të ketë qëllim ushtrimin e ndikimit për të kryer një apo më shumë vepra terroriste. Kur flasim për veprën penale të nxitjes së urrejtjes nga neni 147 i KPRK-së shihet se formulimi i kësaj dispozite ligjore përmban katër elemente siç janë: nxitja, urrejtja, përçarja dhe mosdurimi prej të cilave mjafton të ndërmerret njëra apo të gjitha, veprime këto të cilat kryhen publikisht e që përmbajnë përqeshjen e vlerave kombëtare, pakicave kombëtare, fyerja e personaliteteve kombëtare historike të pakicave apo grupit etnik, përqeshja e flamurit dhe simboleve ku subjekt pasiv i kësaj vepre penale është kombi dhe bashkësitë etnike në Kosovë por jo edhe të kombeve apo grupeve etnike, racave apo feve që nuk jetojnë në Kosovë dhe se kjo vepër kryhet me dashje si direkte ashtu edhe eventuale e që për pasojë ka cenimin e bashkëjetesës së kombeve, feve, racave apo grupeve etnike që jetojnë në Kosovë. Sa i përket paragrafit të dytë për të cilën është akuzuar i akuzuari kjo dispozitë kërkon kryerjen sistematike, keqpërdorimin e pozitës apo autoritetit dhe shkaktimin e trazirave, dhunës apo pasojave tjera të rënda. Kështu që në këtë drejtim gjykata e shkallës së parë siç u cek më lart ka dhënë arsyetimin ligjor lidhur me këto prova dhe me këtë akuzë të Prokurorisë për të cilat në tërësi pajtohet edhe kjo gjykatë se nuk janë përmbushur kushtet e konsumimit të elementeve qenësore të këtyre veprave penale e që është kusht qenësor që dikush të shpallet fajtor për këto vepra. Është theksuar nga gjykata e shkallës së parë se nuk ka qenë kontestuese mbajtja e ligjëratave në cilësi të imamit të akuzuarit me temat “Revolucioni

Sirian” dhe “Ndihmone Sirinë” mirëpo nga provat që janë administruar shihet se përmbajtja e tyre nuk identifikon kurrfarë thirrje, rekomandimi apo mesazhi të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për të shtytur në kryerjen e aktit terrorist apo bashkangjtitjen në ndonjë organizatë terroriste, nxitjen ose përhapjen publike të urrejtjes, përcarjes ose mosdurimit midis grupeve kombëtare, racore, fetare, etnike apo grupeve të tjera që jetojnë në Republikën e Kosovës. Ligjeratat kanë të bëjnë për luftën në Siri, shkaktarët dhe pasojat e asaj lufte, spjegim i një situatë ndërkombëtare të komplikuar në atë pjesë e interpretuar brenda doktrinës islame. Iu referohet si të paderjtë dhe zullumqarë grupeve dhe shteteve të caktuara në atë pjesë si sektit shiitë të Iranit dhe Libanit me të cilin sekti i cilit i përket i akuzuari- sektit sunitë janë në armiqësi që nga vdekja e profetit Muhamed. Gjykata e shkallës së parë drejtë e ka vlerësuar edhe faktin se pohimi i të akuzuarit “Se nuk është e lehtë me u derdhë gjaku i muslimanëve...” përveç që një thënie e tillë ia ka atribuar i akuzuari profetit Muhamed si dhe siç e thotë edhe gjykata e shkallës së parë pohim i arsyeshëm për secilin njeri pavarësisht se derdhja e gjakut është veprim që nuk duhet të ndodhë asnjëherë por kjo është thënë në kuadër të temës së ligjeratës që e ka mbajtur i akuzuari dhe se duhet gjykuar pohimet e tij nga këndvështrimi i temës “Shiatë rreziku që po i kanoset popullit tonë” ku pikërisht i referohet përfshirjes në konfliktin e Sirisë duke u bërë pjesë e përkrahjes së njëres palë e që në rastin konkret palës në pushtet ka ndikuar në shkatërrimin e asaj shoqërie dhe se kur i njëjti flet për bojkotimin dhe mos bashkëpunimin e tyre fjalën e ka për mos bashkëpunim fetar “fetarisht” duhet bojkotuar” duke mos u përfshirë në shoqatat që përfaqësojnë dhe promovojnë ideologjinë e tyre, për më tepër edhe fakti se këto sekte nuk kanë kurrfarë lidhje me Kosovën dhe nuk kërkohet që të njëjtit të urrehen por thjeshtë të mos bashkëpunohet me ta. Përkitazi me referimin e Kinës dhe Ruisë është fakt notor se këto dy shtete e përkrahin pushtetin në Siri për të cilin i akuzuari i referohet si diktatorial dhe mizor dhe se ekziston një mungesë lirie dhe respekti të drejtave të njeriut për popullin shumicë në atë vend. Po ashtu qëndrimet e të akuzuarit lidhur me Sirinë dhe luftën e saj apo komunitetet fetare në Kosovë gjenden edhe në shkrimet e të akuzuarit të botuara gjatë vitit 2010-2014 të cilat i thekson edhe gjykata e shkallës së parë ku i akuzuari flet për nevojën e respektimit të fqiu pavarësisht përkatësisë fetare për të vazhduar me një video incizim me titull “ligji për Sirinë dhe thirrje për të mos shkuar në Siri” ku i akuzuari shprehimisht thekson se iu bën thirrje dhe se gjithë kohën ka bërë thirrje që të mos shkohet në luftën e Sirisë e po ashtu edhe në intervistën me titull “Ska vehabizëm në Kosovë” të dhënë në gazetën Express në vitin 2013 i njëjti pohon se shkuarja në Siri nuk është detyrim dhe nuk duhet të shkohet në atë luftë e që është vërtetuar edhe me lëshimin e CD-së gjatë shqyrtimit gjyqësor e të vërtetuar edhe nga kjo gjykatë. Pra siç e thotë edhe gjykata e shkallës së parë të gjitha këto publikimi tregojnë qartë qëndrimin e të akuzuarit në raport me besime të tjera ku promovon tolerancën dhe mirëkuptimin ndërmjet tyre dhe kundërshtimin e shkuarjes në luftën në Siri të cilat qëndrime i ka pasur në vazhdimësi dhe se ligjeratat “Revolucioni Sirian” dhe “Ndihmone Sirinë” nuk përmbajnë asnjë element shtytës apo nxitës apo në ndonjë formë atë që e kërkon doemos dispozita e veprave penale për të cilat i akuzuari është akuzuar me qëllim të shtytjes për t’iu bashkangjitur luftës, nxitjes apo përhapjes së urrejtjes ndaj grupit tjetër. Edhe dëshmitari S.M. ka deklaruar se vëllau i tij I. ka shkuar në Siri para vitit 2011 pra para periudhës kur është akuzuar i akuzuari Sh. edhe me të drejtë gjykata e shkallës së parë e ka konsideruar të njëjtën si jo relevante e po ashtu edhe nga dëshmia e dy dëshmitarëve N.A. dhe M.H. nuk është mundur të vërtetohet elementi i shtytjes pasi në dëshmitë e tyre flitet për atë se çka ato mendojnë të

ketë ndikuar e që në këtë drejtim ka ndikuar afërsia me personat që janë bërë pjesë e atyre konflikteve, dhembjes për këto shkuarje dhe nevojës për të gjetur arsyen pse të afërmit e tyre janë bërë pjesë e atyre ngjarjeve si dhe ngushëllimin për humbjen e tyre, mirëpo assesit nuk mund të jetë e mjaftueshme dhe të provohet me ndonjë provë se ata janë ndikuar nga i akuzuari Sh.K. pasi me asnjë provë nuk u vërtetua se të njëjtit kanë qenë në ndonjë raport konkret me të akuzuarin e as ndjekës të ligjëratave të tij e që siç thotë edhe gjykata e shkallës së parë edhe nën supozimin se kanë qenë pjesëmarrës në ligjërata, aty kanë qenë edhe shumë persona të tjerë e të cilët nuk janë ndikuar nga këto ligjërata për t'iu bashkangjitur luftës në Siri. Po ashtu në drejtim të vërtetimit të gjendjes faktike ashtu siç e ka gjetur gjykata e shkallës së parë shkojnë edhe dëshmitë e dy dëshmitarëve M.H. e cila ka theksuar se djali i saj B.ka marrë pjesë në ligjërata dhe takime fetare në Maqedoni ndërsa dëshmitarja N.A. se vajza e saj V. ka qenë pjesë e një shoqate si dhe djali i axhës së V. një vit më herët ka shkuar në Siri dhe se letra që e ka lënë V.ka një përmbajtje të ngjashme me atë që e ka lënë djali i axhës së saj një vit më herët e që e njëjta ka mund të jetë e ndikuar nga i njëjti. Po ashtu drejtë gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar edhe faktin se vetëm thirrja për të shkuar në Siri pa ndonjë provë se për çfarë pjesëmarrje është bërë shkuarja dhe duke e ndërlidhur me I.M. dhe V.A. ku për të parin nuk dihet se në cilin grup është bashkangjitur ndërsa për të dytën e njëjta është martuar dhe jeton në Siri. Sa i përket veprës së tretë penale shmangia nga tatimi nga neni 313 gjykata e shkallës së parë ka përcaktuar figurën e kësaj vepre penale si dhe elementin cilësues tejakalimin e shumës prej 15.000 euro mirëpo me të drejtë ka theksuar dhe vlerësuar se nuk është vërtetuar me asnjë provë se i akuzuari Sh.K. ka deklaruar të dhënat e pavërteta lidhur me biznesin e tij apo të mos ketë përfshirë të dhëna lidhur me të ardhurat e tij, pasurinë dhe gjendjen ekonomike apo detyrime të tjera që do ta inkriminonin të njëjtin me kryerjen e veprës penale për të cilën është akuzuar nga ana e Prokurorisë. Kjo për faktin se nga dëshmia e dëshmitarit Xh.Sh. dhe raporti i tij nuk është konstatuar se subjekti N.T “Portat” ka deklaruar të dhënat e pavërteta apo ka fshehur të dhëna përkitazi me veprimtarinë e tij biznese pavarësisht shkeljeve të konstatuara në raport e që bëjnë pjesë në konteste të natyrës administrative si dhe nga ky raport theksohet se i akuzuari ka qenë bashkëpunues duke ofruar të gjitha të dhënat e kërkuara nga inspektorët tatimor duke mos kundërshtuar gjetjet e raportit si dhe detyrimet financiare që janë konstatuar nga ekspertiza financiare janë përmbushur në mënyrë vullnetare brenda afatit të caktuar kohor duke iu ulur lartësia e detyrimit tatimor e që këto veprime nuk janë fare elemente të veprës penale për të cilën ai është akuzuar.

Meqë në aktgjykimin e atakuar nuk kemi shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale si dhe gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë nuk kemi as shkelje të ligjit penal.

Nga sa u tha më lartë, e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.258/2018, më 20.09.2018

Procesmbajtësja,
Leonita Lajçi _____

Kryetari i kolegjit- gjyqtarja
1. Mejreme Memaj _____

Anëtarët e kolegjit:

2. Dr.sc.Driton Muharremi_____

3. Afrim Shala_____